



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.447/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET E PAS AFATSHME ankesa e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.447/2025 datë 07.02.2025, parashtruar kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.447/2025 nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Komuna Prishtinë në të cilën pretendohet se më datë 7 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Gafurr Dugolli, ka publikuar një video në mbështetje të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, gjegjësisht të kandidatit z. Enver Dugolli, nga radhët e subjektit politik LVV, për qëllime të argumentimit të afatshmërisë së ankesës, PDK, njofton PZAP se kjo video është shpërndarë në story të rrjetit social Facebook në profilin e z. Gafurr Dugolli rreth orës 13:00/h. Më tutje në ankesë ka theksuar se PZAP, përmes vendimit A.nr.259/2025 datë 01.02.2025, ka gjetur përgjegjëse subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje për shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me ç' rast i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 6,000.00 €. Më tutje në ankesë ka theksuar se në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë për bazë

shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, nga PZAP ka kërkuar që të merrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së, dhe ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

PZAP-i me datë 08.02.2025 iu drejtua me kërkesë për përgjigje subjektit Lëvizja Vetëvendosje, LVV deri më datën 08.02.2025 në ora 18:30.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, ka theksuar se në ankesë kemi pretendime mbi një bazë ligjore e cila nuk e sanksionon një sjellje të tillë, nëse nëpunësi publik përkrah një subjekt të caktuar, pasi që e drejta për të përkahur një subjekt të caktuar publikisht kufizohet vetëm për kategori të veçanta që parasheh Rregullorja Zgjedhore nr. 07/24 në nenin 5 të saj, ku nëpunësit civil nuk ju lejohet që në orar të punës të jenë pjesë aktive e fushatës dhe jo që kjo e drejtë është rreptësisht e ndaluar. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se një kufizim i të drejtës për të shprehur bindjet politike ashtu siç tenton ankuesi të arrij me këtë ankesë nuk ka mbështetje në ligj, as në rregullore sepse neni 36 i LZP-së ndalon shfrytëzimin e hapësirave si zyre të organeve shtetërore, dhe jo personat fizik që punojnë në këto institucione, ndërsa neni 5 kur përmend taksativisht kategoritë e personave që nuk ju lejohet pjesëmarrja e nëpunësit publik nuk i ndalon por i kufizon brenda orarit të punës që të mos marrin pjesë në fushatë, për çka ankuesi me provat e bashkangjitura ka dështuar të dëshmojë se kjo ka ndodhur ose në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes ose gjatë orarit të punës të sekretarit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesa është e pas afatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë datë 07.02.2025, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilin janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP, më datë 07.02.2025, në të cilën ka pretenduar se më datë 7 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik LVV, aktualisht sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e

Mbrojtjes z.Gafurr Dugolli, ka publikuar një video në mbështetje të subjektit politik LVV, gjegjësisht të kandidatit z.Enver Dugolli, nga radhët e subjektit politik LVV.

Megjithatë, ankesa është parashtruar nga subjekti politik PDK pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesa është dorëzuar më 07.02.2025, ndërkohë që shkelja në fjalë nuk është vërtetuar se kur është postuar postimi në fjalë, përderisa barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 118 paragraf 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 3 nen, par. 3 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.447/2025 datë 10.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.